



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Numri i lëndës: 2024:077457  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05758582

**K.Dh.Shk.II.nr.1057/2024**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Ramush Bardiqi, anëtare të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit/propozuesit të masës së sigurimit “Shkëlqimi Invest” SH.P.K., me seli në Prishtinë, NUI: 811585481, i përfaqësuar sipas autorizimit nga Arbër Shala, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Zyle Millaku Gojnovci nga Avokatura Shtetërore, për shkak të caktimit të masës së sigurisë, duke vendosur lidhur me ankesën e kundërshtarit të sigurimit, të parashtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.197/24, i datës 04.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.29.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** ankesa e kundërshtarit të sigurimit Ministria e Drejtësisë, me seli në Prishtinë, dhe **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KE.nr. 197/24, i datës 04.04.2024, ashtu që çështja gjykohet si në vijim; **REFUZOHET** propozimi për caktimin e masës së sigurisë e propozuesit “Shkëlqimi Invest” SH.P.K., me seli në Prishtinë si e pa bazuar.

## A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e ankimuar, ka vendosur si në vijim:

I. “I.APROVOHET si i bazuar propozimi i propozuesit të masës së sigurimit “Shkelqimi Invest” SH.P.K., i paraqitur kundër të paditurit/kundërshtarit të masës së sigurimit Ministria e Drejtësisë, CAKTOHET masa e sigurisë dhe i NDALOHET kundërshtarit të masës së sigurimit Ministria e Drejtësisë që të bëjë ekzekutimin e sigurimit të ekzekutimit të aktivitetit të prokurimit “Ndarja e hyrjes për vizitor dhe staf në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan”, nr. prokurimi 33600-23-2108-5-2-1, pjesë përbërëse e policës nr. 120258 në shumën prej 2,494.50€.

II. Masa e sigurimit mbetet në fuqi deri sa mos të jepet vendim tjetër mbi masën e sigurimit.”

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ankesë ka paraqit kundërshtari i masës së sigurimit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë që të aprovojë ankesën si të bazuar ta prish aktvendimin KE.nr. 197/24, i datës 04.04.2024, si dhe të lejohet konfeskimi i garancionit të propozuesit në shumë prej 2,49.50euro.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitë propozuesi i masës së sigurisë

Kolegji i Gjykatës Komerciale - Dhoma e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e ankimuar, përgjigjes në ankesë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi - propozuesi i masës së sigurisë Shkelqimi Invest” SH.P.K., me seli në Prishtinë, me datën 08.03.2024, pranë gjykatës së shkallës së parë kanë paraqitur padi, njëherit ka paraqit edhe propozim për caktimin e masës së sigurisë ndaj kundërshtarit të sigurimit Ministria e Drejtësisë, ku propozuesi ka kërkuar që të caktohet masa e sigurisë dhe t’i ndalohet kundërshtarit të sigurimit konfeskimi i garancionit të paditësit në

shumën prej 2,494.50€.euro, deri në vendosjen meritore sipas kërkesëpadisë së paditësit, duke i propozuar gjykatës që ta aprovohet propozimi për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së sigurimit, me aktvendim, e ka aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, me arsyetim se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së. Ndër të tjera ka theksuar se bazuar në provat të cilat gjinden në shkresa të lëndës gjatë shikimit përkatësisht gjatë shikimit të sigurimit të ekzekutimit të aktivitetit të prokurimit “Ndarja e hyrjes për vizitor dhe staf në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan”, nr. prokurimi 33600-23-2108-5-2-1, pjesë përbërëse e policës nr. 120258 gjeti se garancioni me kërkesë të parë në shumën e limituar prej 2,494.50€, do ti lëshohet autoritetit kontraktues – Shërbimi Korrektues i Kosovës nga Kompania e Sigurimeve ELSIG, në emër të Operatorit Ekonomik “Shkelqimi Invest” SH.P.K., në rast se: a) *Autoriteti kontraktues konstaton në bazë të dëshmive të vërtetuara objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutoj kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substanciale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë, dhe b) Operatori Ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbetë pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe/ose furnizues të materialeve*

Pavarësisht faktit se në rastin konkret është përcaktuar se garancioni do të ekzekutohet me kërkesën e parë të autoritetit kontraktues, i njëjti përbën garancion me kusht, për ekzekutimin e të cilit kërkohet që të vërtetohet në mënyrë objektive, dështimi i operatorit ekonomik në ekzekutimin e kontratës dhe shkaktimi i dëmeve autoritetit kontraktues si pasojë e mos ekzekutimit të të njëjtës, nga e cila rezulton se kërkesa e propozuesit të masës së sigurimit, për ndalimin e ekzekutimit të sigurimit të ekzekutimit të tenderit është e bazuar, për faktin se me asnjë provë kundërshtari i masës së sigurimit, nuk ka arritur që ta vërtetojë faktin se është plotësuar njëri nga kushtet e përcaktuara në këtë garancion, përkatësisht që të njëjtit në këtë fazë të procedurës i takon e drejta për ekzekutimin e garancionit.

Nisur nga një gjendje e tillë faktike e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i gabuar pavarësisht se aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat Dhoma e Shkallës së

Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, por gjendja faktike dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar, prandaj Dhoma e Shkallës së Dytë ka vendosur që ta ndryshoj aktvendimin e gjykatës së dhomës së shkallës së parë.

Për caktimin e masës së sigurisë sipas dispozitës së nenit 297.1 nënpikën a) dhe b) të LPK-së kërkohen që të plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative që do të thotë se njëra prej tyre nuk plotësohet atëherë masa e sigurisë nuk mund të caktohet. Në këtë çështje në mes palëve kontestues është fakti se me ekzekutimin e garancioneve, më hollësisht të përshkruara në dispozitivin e parë (I) të aktvendimit të ankimuar a do të mund të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesëpadsisë.

Gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsyetim lidhur me këtë fakt kontestues, se pse vështirësohet apo pamundësohet dukshëm realizimi i kërkesëpadsisë nëse kjo masë e sigurisë nuk shqiptohet kur është e ditur se kundërshtari i propozimit është institucion shtetëror dhe ka buxhet të konsoliduar dhe të përhershëm.

Pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës secilën veç e veç lidhmërin në mes tyre Gjykata e Dhomës së Shkallës së Dytë ka vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, që do të thotë e ka refuzuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së sigurisë .

Gjykata e Dhomës së Shkallës së dytë thekson se nuk janë përmbush kushtet e parapara me nenin 297.1 nënpikë a) dhe b) për caktimin e masës së sigurisë ngase propozuesi nuk ka arrit të bëjë të besueshme kërkesën e saj e sidomos faktin se pa masën e sigurimit vështirësohet në mënyrë të dukshme apo pamundësohet realizimi i kërkesëpadsisë.

Gjykata e Shkallës së dytë konsideron dhe thekson se po që se propozuesi e realizon kërkesëpadsinë e vet atëherë e realizon edhe shumën prej 2,494.50 euro, të deponuar si garancion në rast të mos përmbushjes së kontratave edhe atë me kamatë ligjore nga dita e deponimit të padsisë pranë gjykatës.

Në rastin konkret, sikurse e kemi cek edhe më lartë kundër propozuesi është institucion shtetëror dhe burimet e saja financiare janë nga buxheti i Republikës së Kosovës, kështu që realizimi i kërkesëpadsisë së propozuesit nëse ajo vendoset me aktgjykim të formës së prerë është qartësisht

e realizueshme pa ndonjë vështirësi. Andaj e gjitha varet nga epilogu që do të mirët për çështjen kryesore.

Nga këto arsye, Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkalles së Dytë vlerëson ndryshe gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe gjen se në rastin konkret plotësohen kushtet ligjore që ankesa të aprovohet dhe aktvendimi i ankimuar të ndryshohet, duke refuzuar propozimin për caktimin e masës siguruuese.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

### **Dhomat e Shkallës së Dytë**

K.Dh.Sh.II.nr.1057/24, me datën 29.05.2024

Kryetare e kolegjit  
Saranda Bogaj Sheremeti